



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1556/12 prot.

Datë 19.08.2024

V E N D I M

Nr. 1077/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri Kryetar
Fiorent Zguro Nënkyetar
Kreshnik Ternova Anëtar
Gjergj Mersini Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.08.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.975/2024, datë 30.07.2024, për procedurën e prokurimit “E Hapur - Shërbime - Prokurim me mjete elektronike”, me Nr. **REF-00802-04-09-2024**, me objekt “*Supervizion punimesh Zgjerimi i superstradës Tiranë - Durrës (Faza II)*” me fond limit: **12,727,875.39** (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*TOWER*” SHPK, me NIPT L21717003H, me adresa: Njësia Bashkiake nr.2, Rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr. Pasurie 6, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 30.07.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.975/2024, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “TOWER” SHPK për procedurën e prokurimit “E Hapur - Shërbime - Prokurim me mjete elektronike”, me Nr. **REF-00802-04-09-2024**, me objekt “Supervizion punimesh Zgjerimi i superstradës Tiranë - Durrës (Faza II)” me fond limit: **12,727,875.39** (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “TOWER” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2492/7 prot., datë 05.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1556/9 prot., datë 08.08.2024, autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 975/2024, datë 30.07.2024, si vijon: “...Komisioni i vlerësimit të ofertave ka bërë rivlerësimin për s ai përket procedurës së prokurimit të lartpërmendur në përputhje dhe në zbatim të Vendimit Nr. 975/2024, datë 30.07.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, të pasqyruar në procesverbalin bashkëlidhur këtij informacioni”.

-procesverbal nr. 4 datë 05.08.2024 mbi rivlerësimin e ofertave të paraqitura;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 2492/7 prot., datë 05.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1556/9 prot., datë 08.08.2024, autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 975/2024, datë 30.07.2024, si vijon: “...Komisioni i vlerësimit të ofertave ka bërë rivlerësimin për s ai përket procedurës së prokurimit të lartpërmendur në përputhje dhe në zbatim të Vendimit Nr. 975/2024, datë 30.07.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, të pasqyruar në procesverbalin bashkëlidhur këtij informacioni”.

-procesverbal nr. 4 datë 05.08.2024 mbi rivlerësimin e ofertave të paraqitura;

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik dhe ka rivlerësuar operatorin ekonomik “TOWER” SHPK në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.975/2024, datë 30.07.2024.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E Hapur - Shërbime - Prokurim me mjete elektronike”, me Nr. **REF-00802-04-09-2024**, me objekt “Supervizion punimesh Zgjerimi i superstradës Tiranë - Durrës (Faza II)” me fond limit: **12,727,875.39** (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

